



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:265171

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520073

CP.nr.202/13

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri dhe bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit K... SH.A. me adresë në ... me seli në Prishtinë, kundër debitorit H.B nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, lidhur me pagesën e borxhit, jashtë seance me datën 28.03.2024, mori këtë:

K O N K L U Z I O N

I. PEZULLOHET procedura përmbareme në çështjen CP.nr.202/13 për shkak të vdekjes së debitorit H.B.

II. Procedura e pezulluar sipas pikës I të këtij konkluzioni, mund të vazhdoj nëse kreditori në afat prej 6 muajsh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, gjykatës i propozon caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për debitorin H.B, në të kundërtën, procedura e pezulluar konsiderohet e përfunduar.

A r s y e t i m

Kreditori K... SH.A, me datë 28.03.2012, ka paraqitur propozim për përmbareme kundër debitorit H.B nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, në bazë të dokumentit të besueshëm, dhe atë faturës me numër 2/2013/R – 4606854, të datës 28.02.2013, me të cilën është obliguar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 4,665.95 Euro, në emër të borxhit si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata me aktvendimin CP.nr.202/13 të datës 03.11.2014 ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit. Nga certifikata e vdekjes e datës 20.02.2023, me numër të referencës ... gjykata ka konstatuar se debitori ka vdekur me datën *data e vdekjes*.

Meqenëse nga dita e vdekjes e deri më sot nuk është propozuar përfaqësuesi i përkohshëm për debitorin H.B, dhe as nuk ka marrës përsipër të procedurës në këtë çështje, gjykata, konform nenit 35 par. 4 lidhur me nenin 65 të Ligjit për Procedurën Përbarimore vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CP.nr.202/13, me datë 28.03.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.